



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUÇITRAN

01 Nr. / Br 211/20

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data: / Datum 29. 10. 2020

VUŠITRAN, VUÇITRAN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës - Vushtrri

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2 pika "d" të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 41, paragrafi 2, pika "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **29 tetor 2020**, merr këtë:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E UDHËZUESIT TË PËRGJITHSHËM PËR PJESËMARRJEN E QYTETARËVE - PLANIT TË PJESËMARRJES QYTETARE-NË NIVEL LOKAL

1. Me këtë vendim aprohet Udhëzuesi i përgjithshëm për pjesëmarrjen e qytetarëve - Planit të pjesëmarrjes qytetare –në nivel lokal.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Zyra për Komunikim me Publikun dhe drejtoritë komunale.
3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.




Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRA	
01 Nr. / Br	212/20
Nr. i fq. / Br. st	- 1 -
Data / Datum	29. 10. 2020
VUSHTRRI - VUČITRA	



Kuvendi i Komunës - Vushtrri

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, pas shqyrtimit të Draft-Rregullores për Realizimin e të Drejtave, Përkujdesjen Mbrojtjen dhe Parandalimin e Punëve të Rënda për Fëmijët, duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 1, pika "d" të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 12 të Statutit të Komunës, nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) NR. 04/2018 për Transparencë në Komuna në lidhje me nenin 18 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) NR. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, si dhe nenin 2 të Rregullores për Transparencë 01Nr.99/13, dt. 25.4.2013, në mbledhjen e mbajtur më 29 tetor 2020, merr këtë:

VENDIM PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Realizimin e të Drejtave, Përkujdesjen Mbrojtjen dhe Parandalimin e Punëve të Rënda për Fëmijët.
2. Diskutimi publik fillon nga data 30 tetor 2020 dhe zgjat deri më 26 nëntor 2020.
3. Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.
4. Obligohet komisioni komunal që si hartues i draft-rregullores në fjalë, të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet komisioni i sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantojë Kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-rregullores në fjalë, në mbledhjen e kuvendit në muajin nëntor 2020.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.



Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA	
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRA	
01 Nr. / Br	213 / 20
Nr. i fq. / Br. st	- 1 -
Data: / Datum	29. 10. 2020
VUSHTRRI - VUČITRA	



Kuvendi i Komunës - Vushtrri

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, pas shqyrtimit të Draft-Strategjisë komunale për komunikim 2021-2023, duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 1, pika "d" të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 12 të Statutit të Komunës, nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) NR. 04/2018 për Transparencë në Komuna në lidhje me nenin 18 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) NR. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, si dhe nenin 2 të Rregullores për Transparencë 01Nr.99/13, dt. 25.4.2013, në mbledhjen e mbajtur më **29 tetor 2020**, merr këtë:

VENDIM PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft- Strategjia komunale për komunikim 2021-2023.
2. Diskutimi publik fillon nga data 30 tetor 2020 dhe zgjat deri më 26 nëntor 2020.
3. Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.
4. Obligohet zyrtari për informim që si hartues i draft-strategjisë në fjalë, të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet zyrtari i sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantojë Kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-strategjisë në fjalë, në mbledhjen e kuvendit në muajin nëntor 2020.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.



Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit